



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 740/7 Prot.

Tiranë, më 19.08.2026

V E N D I M

Nr. 228, Datë 19.08.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 97, datë 22.04.2026, të paraqitur nga z. J.M dhe znj. V. K kundër Shoqërisë Leo Gita Travel sh.p.k, me Nipt K31406538L, ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesit z. J.M dhe znj. V. K parashtojnë se:

“Unë J.M, në cilësinë e Zv.Presidentit të Shoqatës Kombëtare Shpresë për të Verbërit si dhe zonja V. K, në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme të Shoqatës Kombëtare Shpresë për të Verbërit, në datë 12.04.2026, në orën 10 të mëngjesit, kishim një takim pune në degën e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” për degën e Burrelit.

Konkretisht kishim zgjedhjet e organeve drejtuese të kësaj dege, si kryetarin dhe bordin drejtues. Në orën 8 të mëngjesit, tek terminali i Durrësit, stacioni i trenit, hipëm që të dy në furgonin e linjës së transportit të udhëtarëve të linjës Durrës-Burrel, që kryen shërbimin e transportit, nga kompania Genti trans me furgonin me targë AB-820 SO dhe me numër telefoni 069 25 141 61. Gjatë rrugës ne komunikuam me shoferin, mësuam se nisja nga Burreli për në Durrës bëhej në orën 13:30. Këtu mësuam se ky ishte furgoni i fundit që nisej nga Burreli dhe nuk kishte tjetër.

¹ Në vijim referuar me LMD.

² Në vijim referuar me Komisioneri.

Në orën 09:45 arritën në Burrel dhe kur zbritëm i dhamë lekët shoferit për pagesën 50% sipas ligjit. Ai na tha se unë dua pagesën e plotë, se jam privat dhe nuk e njoh ligjin dhe nuk do të paguaj lekët tuaja, sepse pronari më ka vendosur kamera dhe mi numëron pasagjerët. Me këmbënguljen tonë, komunikoi me telefon me pronarin dhe ai tha merrja nga 400 lekë nga 300 që ishte 50% e biletës së plotë që ishte 600 lekë të reja. Në debat e sipër ne pranuan të paguajmë 400 lekë duke kërkuar që të na pajiste me biletë të kësaj linje, ai nuk na dha biletë.

Pasi mbaruam mbledhjen në orën 12:30, u drejtuan në vendin ku qëndronin furgonët, pyetëm ku qëndronin furgonët për në Durrës dhe pasagjerët që ndodheshin aty ku ishin furgonët e Tiranës, na thanë se furgoni i Durrësit qëndron tek agjencia e vjetër. Me mundin duke pyetur gjatë rrugës rreth orës 12:55 e gjetëm furgonin që po priste për tu mbushur me pasagjerë, hymë brenda në furgon, ku në atë moment nuk kishte asnjë pasagjer tjetër. Ende pa u ulur, na vjen shoferi duke na bërë titur dhe duke na thënë të zbresim poshtë. Ne i kërkuam pse duhet të zbrisnim, ai na pa dhe pa na dhënë asnjë shpjegim na kapi prej krahu dhe na zbriti me dhunë nga furgoni. Në këto kushte ne u detyruam të kërkojmë ndihmën e policisë, duke telefonuar numrin 129. Ata na u përgjigjën menjëherë duke na thënë se po ju dërgojmë patrullën.

Shoferi pasi na nxori me dhunë nga furgoni, mbylli derën e furgonit, ndërkohë ne prisnim patrullën të vinte, vijnë tre pasagjerë dhe shoferi u hapi derën e furgonit dhe i hipi brenda. I thamë që të hipnim edhe ne kundrejt pagesës së plotë, se s'kemi mundësi tjetër për të ardhur në Durrës, por ai na tha se nuk ju marr se e kam të mbushur rrugën me pasagjerë dhe duke na mashtruar na tha që hajdeni me furgonin tjetër të orës 14:30, kur ne e dinim shumë mirë që nuk kishte me furgon tjetër për në Durrës. Në këtë moment, shoferi merr vesh se ishte nisur patrulla e policisë dhe ndezi makinën dhe ikën me nxitim. Unë dhe V., dolëm para makinës dhe ia morëm targën e kësaj makine me numër targe AB 820 SO. Sapo furgoni u largua, erdhi patrulla e policisë, të cilët na pyetën se kush kërkoi ndihmën e policisë. Ne i thamë se jemi ne ato që kërkuam ndihmën tuaj. Ata pyetën se çfarë problemi kishim dhe i shpjeguam të gjithë ngjarjen që kishte ndodhur edhe atë të mëngjesit, duke i thënë policisë së furgoni është nisur bosh para orarit. Ata na kërkuam targën dhe ne ia dhamë.

Policia u vu në kërkim të furgonit, sepse ne i dhamë të dhënat që furgoni kishte orarin e nisjes në orën 13:30. Në orën 13:29, në komunikua përsëri me policinë dhe na thanë që të prisnim aty për të na njoftuar. Ne u larguam nga agjencia e vjetër për të qëndruar te furgonët e Tiranës, duke ditur se te agjencia e vjetër nuk kishte më furgon për në Durrës. Lajmi që na tha shoferi se ishte edhe një furgon tjetër në orën 14:30, ishte i rremë. Në orën 13:49, policia na kërkon se ku ndodheshim dhe ne ju përgjigjëm se ndodheshim te vendi ku nisen furgonët për në Tiranë. Aty erdhi makina e policisë, na mori dhe na çoi te furgoni i Durrësit që ishte larguar. Kur hipëm në furgon, pamë se ishin vetëm tre pasagjerë dhe sediljet e tjera ishin bosh. Ne u ulëm në sediljen e dytë pas shoferit, por shoferi duke shfryrë dufin e tij, na urdhëroi të uleshim në fund të furgonit. Ne nuk e kundërshtuam, por zbatuam urdhrin e tij për të mos bërë debat, duke zbatuar këshillën e policisë që gjatë rrugës na këshilluan që të mos bënim asnjë debat me shoferin dhe me pasagjerët

që ishin në furgon. Gjatë rrugës sediljet ishin bosh, sepse gjatë rrugës hipën vetëm shtatë pasagjerë dhe ata hipën dhe zbritën gjatë rrugës pa arritur në Durrës. Në Durrës arritëm në terminal, te stacioni i trenit në orën 15:31. Ishim shumë të stresuar nga ngjarja që ndodhi.”

Ankuesit kërkojnë nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojave që shkakton moszbatimi i ligjit nr. 8098 neni 11/1 nga ky subjekt.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 740/4 prot., datë 29.05.2026, Komisioneri kërkoi informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen nga shoqëria Leo Gita Travel sh.p.k në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Konkretisht subjektit i është kërkuar:
 - Kopje të ekstraktit të Shoqërisë Leo Gita Travel sh.p.k, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
 - Informacion nga ana e Shoqërisë Leo Gita Travel sh.p.k lidhur me pretendimet e paraqitura nga ankuesit.
 - Informacion në lidhje me dokumentacionin që është paraqitur nga pala ankuese për të përfituar nga lehtësirat në transport për personat me aftësi të kufizuara.
 - Informacion nëse nga ana e Shoqërisë Leo Gita Travel sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në legjislacionin specifik.
 - Informacion lidhur me masat e ndërmarra nga ana e shoqërisë për sqarimin e zgjidhjen e kësaj problematike.
 - Kopje të rregullores së brendshme të shoqërisë dhe kopje të rregullores mbi mënyrën e ofrimit të shërbimit të transportit dhe a ka në rregullore parashikime të posaçme mbi mënyrën e ofrimit të shërbimit për personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi e në veçanti për personat e verbër? A është e afishuar kjo rregullore në mjetet e transportit nëpërmjet të cilave ofrohet shërbimi nga ana e shoqërisë?
 - Kopje të plotë të licencës të lëshuar për operimin nga autoriteti përgjegjës në linjën Durrës-Burrel-Durrës, si dhe licencat e lëshuara për mjetet e transportit të përdorura nga shoqëria në këtë linjë.
 - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Rezulton se subjekti ka marrë dijeni për këtë shkresë, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar Nr. RR838030882AA administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.

2. Me shkresën nr. 740/6 prot., datë 20.07.2026, Komisioneri i është drejtuar sërish subjektit me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit, për të dërguar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke i sjellë në vëmendjen se mosplotësimi i kësaj kërkesë, përbën shkelje të dispozitave të LMD-së.

Subjekti ka marrë dijeni për shkresën nr. 740/6 prot., datë 20.07.2026, më datën 22.07.2026, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar me Nr. RR864179895AA, por nuk ka kthyer përgjigje.

III. Pas kryerjes së hapave të mësipërm proceduralë, Komisioneri çmon se:

Shoqëria Leo Gita Travel sh.p.k, si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa nr. 97, datë 22.04.2026, me dijeninë e plotë nuk ka mbështetur Komisionerin në ushtrimin e kompetencës së tij ligjore për të shqyrtuar ankesat për diskriminim, të përcaktuar në nenin 32/1/a, të LMD-së duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, Shoqëria Leo Gita Travel sh.p.k nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/2, të LMD-së, sipas të cilit: *“2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”* Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33/13, të LMD-së shoqërohet me marrjen e masës administrative, gjobë.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Shoqëria Geo Gita Travel sh.p.k, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32/2, të LMD-së, shkelje e cila sipas nenit 33/13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Për personat juridik, siç është në rastin konkret është Shoqëria Leo Gita Travel sh.p.k, neni 33, pika 13, të LMD-së, përcakton shkrehimisht: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”:*..... *b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....”*

Në lidhje me përcaktimin e masës së gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të LMD-së, ku sanksionohet se: *“12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në*

konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe faktin që subjekti nuk ka dhënë informacionin e kërkuar zyrtarisht, pavarësisht kërkesave të përsëritura, Komisioneri arrin në përfundimin se, Shoqëria Leo Gita Travel sh.p.k duhet të gjobitet me 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç” dhe pika 2, nenin 33, pikat 11, 12, 13 e 14, 18, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Shoqëria Leo Gita Travel sh.p.k, me Nipt K31406538L, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.97, datë 22.04.2026.
2. Gjoka të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda një muaji nga marrja dijani, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Dërgimi i informacionit të kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)